

Përmbledhje e gramatikës

Këtu janë paraqitur:

A Një përmbledhje e sintaksës

- I Lidhëzat bashkërenditëse që bashkojnë pjesët kryesore të fjalisë
 1. Lidhëza bashkërenditëse **und**
 2. Lidhëza bashkërenditëse **aber**
 3. Lidhëza bashkërenditëse **sondern** (pas mohimit)
- II Lidhëzat bashkërenditëse që bashkojnë pjesën kryesore me pjesën e varur të fjalisë.
 1. Pjesët e varura që nisin me **weil**
 2. Pjesët e varura që nisin me **daß**
 3. Pjesët e varura (kohore) me **als/bevor**
- III Përmbledhje e rendit të fjalëve në pjesën kryesore të fjalisë.
 1. Folja në vend të dytë
 2. Folja në vend të parë (në krye të fjalisë)
 3. Korniza (foljore) e fjalisë/Foljet e ndashme
 4. Folje të ndjekura nga një kundrinor i drejtë dhe i zhdrejtë
 5. Rendi i disa gjymtyrëve plotësuese të fjalisë
 6. Rendi i ndajfoljeve

B Pjesët e ligjëratës

- I Folja
 1. Koha e ardhshme
 2. Imperfekti i foljeve të rregullta
 3. Imperfekti i foljeve modale
 4. Imperfekti i foljeve të parregullta
 5. Folje me parafjalë të qëndrueshme
- II Mbiemri
 1. Lakimi i mbiemrave
 2. Krahasimi me **wie**
 3. Prapashtesat mbiemërore
- III Përemri i pacaktuar (nyja e përdorur si përemër)
- IV Përemri pyetës **welch-**
- V Parafjala

A Një përmbledhje e sintaksës

- I **Lidhëzat bashkërenditëse që bashkojnë pjesët kryesore të fjalisë**
Dy pjesë kryesore të fjalisë mund të bashkohen me anë të një lidhëze bashkërenditëse, si p.sh. **und**, **aber** ose **sondern**. Lidhëza bashkërenditëse vendoset midis dy pjesëve të fjalisë.

1. Lidhëza bashkërenditëse *und*

und (dhe) bashkon dy pjesë kryesore të fjalisë, ku pjesa e dytë jep një informacion plotësues për pjesën e parë kryesore të fjalisë. **Und** zë vend midis dy pjesëve kryesore të fjalisë. Para **und** vihet një presje, kur ajo ndiqet nga një pjesë kryesore e plotë e fjalisë, me kryefjalë.

- a) Hier gibt es sehr viel Industrie.
b) Hier leben sehr viele Menschen.
Hier gibt es sehr viel Industrie, **und** hier leben sehr viele Menschen.

2. Lidhëza bashkërenditëse *aber*

aber (por) shpreh një kundërshtim. Para **aber** vihet gjithnjë presje.

- a) Früher gab es hier sehr viel Eisenindustrie.
b) Heute ist das anders.
Früher gab es hier sehr viel Eisenindustrie, **aber** heute ist das anders.

3. Lidhëza bashkërenditëse *sondern* (pas një thënieje mohuese)

sondern (por) shpreh gjithashtu kundërshtim. **Sondern** përdoret në vend të **aber**, kur pjesa kryesore e fjalisë që vjen e para përmban një thënie mohuese. Para **sondern** gjithmonë vihet presje.

- a. Der Himmel ist **nicht** mehr grau.
b. Der Himmel ist wieder blau.
Der Himmel ist nicht mehr grau, **sondern** (der Himmel ist) wieder blau.

Në qoftë se të dyja pjesët kryesore të fjalisë kanë të njëjtën kryefjalë dhe të njëjtin kallëzues (folje) – si në shembullin e mëposhtëm kryefjala *der Himmel* dhe folja *ist* – në pjesën kryesore të fjalisë, që vjen e dyta, këto gjymtyrë mund të mos përsëriten.

Der Himmel ist nicht mehr grau, sondern wieder blau.

II Lidhëzat nënrenditëse që përdoren për të bashkuar pjesë kryesore me pjesë të varura të fjalisë.

Pjesët e varura të fjalisë nuk mund të qëndrojnë më vete. Ato kanë nevojë gjithnjë për një pjesë kryesore për t'iu referuar. Një pjesë kryesore e fjalisë mund të bashkohet me një pjesë të varur të fjalisë me anë të një lidhëze nënrenditëse. Vini re: në fjalinë e varur, folja zë vend gjithnjë në fund të fjalisë.

Zakonisht, fjalia fillon me pjesën kryesore, e cila ndiqet nga pjesa e varur. Ky është rendi i zakonshëm, kur pjesa e varur lidhet me pjesën kryesore me *weil* ose me *daß*. Në fjalitë kohore, ku pjesa e varur fillon me lidhëzat *als* ose *bevor*, në përgjithësi në krye të fjalisë vihet pjesa e varur.

1. Pjesa e varur me lidhëzën *weil*

weil (sepse) është një lidhëz nënrenditëse, që shpreh shkakun, arsyen për diçka. Në një fjali, ku pjesa kryesore lidhet me atë të varur me lidhëzën **weil**, folja shkon në fund të fjalisë.

Pjesë kryesore: Wir fahren in die Kantstraße.	Wir schlafen da.
Pjesa kryesore: Wir fahren in die Kantstraße,	
Pjesa e varur: weil wir da schlafen.	

Në gjermanishten e folur, pjesa kryesore, së cilës i referohet pjesa e varur shpesh lihet jashtë, për hir të shkurtësisë.

Pyetje: *Warum beißt der Bahnhof Zoo so?*

Përgjigje e plotë: *Der Bahnhof Zoo beißt so, weil der Zoo ganz in der Nähe ist.*

Përgjigje e shkurtër: *Weil der Zoo ganz in der Nähe ist.*

2. Pjesa e varur me *daß*

daß (që) është një lidhëz nënrenditëse që përdoret pas foljeve të tilla si **them**, **mendoj** ose **di**. Më poshtë jepen disa folje, pas të cilave përdoret dendur pjesa e varur me *daß*.

denken, daß ...	Ich denke, daß wir Berlin besichtigen.
wissen, daß ...	Du weißt, daß es Kriege gibt.
es ist schön, daß ...	Schön, daß Sie da sind.

3. Pjesa e varur kohore me *als*, *bevor*

als është një lidhëz e nënrenditur kohore. Ajo përdoret kur veprimi në pjesën kryesore të fjalisë ndodh në të njëjtën kohë me veprimin në pjesën e varur. *Als* mund të përdoret vetëm me folje në kohë të shkuar (p.sh. në imperfekt)

Als kërkon që folja në pjesën e varur të zërë vend në fund të fjalisë.

Pj.kr. = Pjesa kryesore, Pj.v. = Pjesa e varur

Pj.kr: Es gab zwei deutsche Staaten. Bonn war die Hauptstadt der Bundesrepublik Deutschland.
Pj.v.: Als es zwei deutsche Staaten gab,
Pj.kr: war Bonn die Hauptstadt der Bundesrepublik Deutschland.

bevor (përpara se) është gjithashtu një lidhëz nënrenditëse kohore. Ajo përdoret kur veprimi në pjesën kryesore të fjalisë ndodh përpara veprimit në pjesën e varur.
Bevor kërkon që folja në pjesën e varur të zërë vend në fund të fjalisë.

Pj.kr.: Hier war (früher) viel los. Dann war die Mauer da. Pj.v.: Bevor die Mauer da war, Pj.kr.: war hier viel los.
--

Mbi fjalitë me nënrenditje me *als* ose *bevor*.

- a) Folja gjithmonë shkon në fund të pjesës së varur.
 b) Zakonisht, pjesa e varur vjen e para. Pjesa kryesore, në këtë rast, fillon me folje.

Pj.v.	Folja	Folja	Pj.kr.
Bevor die Mauer da	war ,	war hier viel los.	
Als es zwei deutsche Staaten	gab ,	war Bonn die Hauptstadt der BRD.	

- c) Në qoftë se e para vjen pjesa kryesore, rendi normal i fjalëve nuk ndryshon. Folja mbetet në vend të dytë.

Pj.kr.	Folja	Folja	Pj.v.
Hier war viel los,		bevor die Mauer da	war.
Bonn war die Hauptstadt der BRD,		als es zwei deutsche Staaten	gab.

- d) Raporti i kohëve në pjesën kryesore dhe të varur të fjalisë.

als: Pjesa kryesore dhe pjesa e varur janë në të njëjtën kohë (kurrë në kohën e tashme).

bevor: Koha në pjesën e varur
 E tashme
 Imperfekt

Koha në pjesën kryesore:
 E tashme ose e kryer
 Imperfekt

III Përmbledhje e rendit të fjalëve në pjesën kryesore të fjalisë

Kr. = Kryefjala, **Kund.dr.** = Kundrinori i drejtë, **Kund.zhd.** = Kundrinori i zhdrejtë

1. Folja në vend të dytë

Në fjali të zakonshme dëftore, folja ndodhet në vend të dytë dhe kryefjala vjen e para.

Kr.	Folja	
Mein Auto	ist	weg.

Edhe në fjalitë pyetëse me përemër pyetës, folja ndodhet në vend të dytë. Kryefjala zë vend pas foljes.

	Folja	Kr.	Kund.dr.
Warum	sagen	Sie	das?
Wie	bekomme	ich	mein Auto jetzt wieder?

Pas disa fjalësh si **natürlich, schließlich** ... që vendosen në fillim të fjalisë për emfazë, folja mbetet në vend të dytë dhe ndiqet nga kryefjala.

	Folja	Kr.	
Natürlich	bin	ich	ganz sicher.
Schließlich	bin	ich	ja nicht blind.
Das	glaube	ich	nicht.

2. Folja në vend të parë (në krye të fjalisë)

Në fjali pyetëse pa përemër pyetës, folja ndodhet në vend të parë. Në fjalitë urdhërore folja rri gjithashtu në vend të parë.

Folja	Kr.	
Sind	Sie	ganz sicher?
Überlegen	Sie	mal!

3. Korniza (foljore) e fjalisë/Foljet e ndashme

- Kur një fjali përmban një folje të ndashme (një folje me parashtesë, pjesëz të ndashme) në kohën e tashme, parashtesa shkon në fund të fjalisë.
- Në kohën e kryer pjesorja shkon në fund të fjalisë.
- Kur një fjali përmban një folje modale, folja e dytë shkon në fund të fjalisë.

	Folja ₁		Folja ₂ /	Parashtesa
a) Ich	hole	meine Frau		ab.
b) Ich	habe	meine Frau	abgeholt.	
c) Ich	möchte	meine Frau	abholen.	

4. Folje të ndjekura nga një kundrinor i drejtë dhe i zhdrejtë.

- a) Në një fjali me rend të zakonshëm të fjalëve, kundrinori i drejtë ose kundrinori i zhdrejtë vjen pas foljes. Nganjëherë, megjithatë, kundrinori vendoset në fillim të fjalisë për t'u theksuar, për emfazë. Kjo ndodh shpesh me kundrinorin e drejtë. P.sh.: **Das glaube ich.**
- b) Kur të dy kundrinorët janë **emra**, kundrinori i zhdrejtë vjen para kundrinorit të drejtë.
- c) Kur njëri nga kundrinorët është emër dhe tjetri përemër, i pari vjen **përemri**.
- d) Kur të dy kundrinorët janë **përemra**, kundrinori i drejtë vjen përpara kundrinorit të zhdrejtë.

Kr.	Folja	Kund.zhd.	Kund.dr.
b) Er	zeigt	dem Mann	das Halteverbot.
c) Er	zeigt	ihm	das Halteverbot.
		Kund.dr.	Kund.zhd.
d) Er	zeigt	es	ihm.

5. Rendi i disa gjymtyrëve plotësuese të fjalisë

Në përgjithësi, gjymtyrët e tjera plotësuese të fjalisë zënë vend pas gjymtyrëve të sipërpërmendura (dhe para foljes së dytë ose parashtesës foljore)

- a) **Rrethantori i gjendjes (i vendit ose i kohës) (wann? – am Samstag; wo? – in Berlin)**
- b) **Rrethantori i drejtimit (i vendit) (wobin? – nach Berlin)**
- c) **Kundrinori me parafjalë** (folja merr automatikisht një parafjalë të përcaktuar qartë, p.sh. **helfen bei**)

Kr.	Folja ₁	Kund.zhd.	Kund.dr.	Shprehje parafj.	Folja ₂
a) Er	schreibt	ihnen	einen Brief	aus Berlin.	geschrieben.
Er	hat	ihnen	einen Brief	aus Berlin.	
b) Er	schreibt	ihnen	einen Brief	nach Hause.	
c) Er	hilft	ihm		bei seiner Arbeit.	

6. Rendi i ndajfoljeve

Ndajfoljet nuk kanë një vend të përcaktuar në fjali. Zakonisht, ato vijnë pas kryefjalës, kundrinorit të drejtë ose kundrinorit të zhdrejtë. Por ato shpesh zënë vend në fillim të fjalisë, për përforsim, për emfazë.

Er möchte eine Freundin **in Brüssel** besuchen.
 Er hat **dort** einen Termin.
 Ex ist **damals** verschwunden.
Am Montag müssen wir wieder arbeiten.
Vielleicht war Ex bei Andreas nicht glücklich.

B Pjesët e ligjëratës

I Folja

1. Koha e ardhshme

Koha e ardhshme (ose e ardhshmja e thjeshtë, e ardhshmja I) formohet me të tashmen e foljes ndihmëse *werden* plus paskajoren e një foljeje të dytë. Koha e ardhshme ka dy funksione:

- I referohet një ngjarjeje ose një gjendjeje të ardhshme.
- Shpreh një supozim.

	Folja ₁		Folja ₂
Da So eine Szene	werde wird	ich mehr Geld es bald nicht mehr	verdienen. geben.

<i>werden</i> : Koha e tashme				
	Njëjës		Shumës	
Veta I	ich	werde	wir	werden
Veta II (familj.)	du	wirst	ihr	werdet
(e mirësj.)	Sie	werden	Sie	werden
Veta III	er/sie	wird	sie	werden

2. Imperfkti i foljeve të rregullta

a) Funksioni

Imperfkti, (e pakryera/e kryera e thjeshtë në gjuhën shqipe), ashtu si koha e kryer, përdoret për të përshkruar ngjarje të së shkuarës. Në dallim nga koha e kryer, imperfkti përdoret për të përshkruar ngjarje që i përkasin vetëm së shkuarës, pa lidhje me të tashmen.

b) Formimi

Imperfkti formohet duke i shtuar **-t-** temës së foljes para mbaresës. Në qoftë se tema mbaron me **-t-** ose **-d-**, atëherë temës së foljes i shtohet për lehtësi shqiptimi **-et**.

Paskajore	Tema e foljes	Formanti i imperfektit	Mbarena (Veta I+III Nj.)
hören arbeiten reden	hör- arbeit- red-	-t- -et- -et-	-e -e -e
Pra: ich/er hörte , ich/er arbeitete , ich/er redete			

Mbaresat e zgjedhimit të foljeve janë të njëjta si në kohën e tashme, me përzjehshmëri të vetës III njëjës. Në të tashmen, mbarena është **-t- (er hört)**. Në imperfekt, veta III njëjës merr mbaresën **-te (er hörte)**:

E tashme: *sie hört* E pakryer: *sie hörte*

E tashme		Imperfekt
	Njëjës	
Veta I Veta II (familjare) (e mirësj.) Veta III	ich hören du hörst Sie hören er/sie hört	ich hörte /arbeitete du hörtest /arbeitetest Sie hörten /arbeiteten er/sie hörte /arbeitete
	Shumës	
Veta I Veta II (familjare) (e mirësj.) Veta III	wir hören ihr hört Sie hören sie hören	wir hörten /arbeiteten ihr hörtet /arbeitetet Sie hörten /arbeiteten sie hörten /arbeiteten

3. Imperfektin i foljeve modale

Gjermanishtja përdor dy kohë për të përshkruar ngjarjet që kanë ndodhur në të shkuarën: kohën e kryer (perfektin) dhe imperfektin (shih mësimin 11). Foljet modale, megjithatë, përdoren rrallë në kohën e kryer. Për të shprehur të shkuarën, folja modale zakonisht vendoset në imperfekt.

a) Formimi

Foljet modale e formojnë imperfektin në të njëjtën mënyrë si foljet e rregullta: temës foljore, para mbaresës së zakonshme të foljes, i shtohet gërma **-t-**.

Paskajore	Tema foljore	Formanti i imperf.	Mbarena
wollen	woll-	-t-	-e, -est, -et, -en
Pra: ich wollte , du wolltest ...			

Imperfekt		
	Njëjës	Shumës
Veta I	ich woll te	wir woll ten
Veta II (familj.)	du woll test	ihr woll tet
(mirësj.)	Sie woll ten	Sie woll ten
Veta III	er/sie woll te	sie woll ten

Foljet modale (*können*, *dürfen*, *müssen*, *mögen*), të cilat në paskajore kanë një umlaut, e humbasin atë në imperfekt.

können: ich **konnte**, **dürfen**: ich **durfte**, **müssen**: ich **mußte**, **mögen**: ich **mochte**

b) Rendi i fjalëve

Kur përdoren si folje ndihmëse (**Folja₁**) foljet modale nuk mund të qëndrojnë më vete. Ato kërkojnë një folje të dytë (**Folja₂**). Folja e dytë (e varur) është në formën e paskajores dhe vendoset gjithmonë në fund të fjalisë.

	Folja ₁		Folja ₂
Niemand	konnte	uns	sehen.
Wir	wollten	unsichtbar	bleiben.
Das	solltest	du selbst	entscheiden.
Warum	durfte	euch niemand	sehen?

4. Imperfekti i foljeve të parregullta

Foljet e parregullta ndryshojnë në imperfekt zanoren e rrënjës së tyre:

geben – gab, kommen – kam, sehen – sah, einfallen – fiel ein

Nuk ka ndonjë rregull për ndryshimin e zanores në imperfekt ose në kohën e kryer. Sa herë që ndeshni një folje të parregullt në gjermanisht, mësojini më mirë të tria format bazë të saj.

P.sh.:

Paskajorja	Imperfekti	Pjesorja e shkuar
kommen	kam	gek ommen

Në fund të këtij libri do të gjeni një listë me foljet e parregullta që ndeshen në Pjesën e Parë, të Dytë dhe të Tretë të kursit të gjermanishtes. Në këtë listë jepen të tria format bazë të foljes.

Në vetën e parë dhe të tretë njëjës, foljet e parregullta nuk kanë mbaresë. Në rastet e tjera ato kanë të njëjtat mbaresa si foljet e rregullta në kohën e tashme.

Imperfekt		
	Njëjës	Shumës
Veta I	ich kam	wir kamen
Veta II (familjare) (e mirësjelljes)	du kamst Sie kamen	ihr kamt Sie kamen
Veta III	er/sie kam	sie kamen

Tri foljet e mëposhtme janë të parregullta:

Paskajore	Imperfekt
gehen tun stehen	er ging er tat er stand

5. Folje me parafjalë të qëndrueshme

Disa folje marrin parafjalë të caktuara. Fjala plotësuese, kundrinori që ndjek foljen vihet në rasën që kërkon parafjala.

berichten von + dhan.:	Das Lied berichtet von den Taten von Mackie Messer.
denken an + kall.:	Er denkt an eine Arbeit beim Rundfunk.
es geht um + kall.:	Es geht um einen einfachen Straßenhändler.
handeln von + dhan.:	Die Geschichte handelt von Räufern.
helfen bei + dhan.:	Er kann ihm bei seiner Arbeit helfen.
hoffen auf + kall.:	Andreas hofft auf kleine Aufträge.
Probleme haben mit + dhan.:	Er hat Probleme mit dem Computer.
sprechen mit + dhan.:	Andreas muß mit seiner Chefin sprechen.
überzeugt sein von + dhan.:	Er ist von der Heilung durch die Natur überzeugt.

II Mbiemri

1. Lakimi i mbiemrave

Mbiemrat që qëndrojnë **pas** një emri nuk e ndryshojnë formën e tyre, d.m.th., nuk marrin mbaresë.

P.sh.: **Der Bahnhof ist alt.**

Mbiemrat që qëndrojnë **para** një emri e ndryshojnë formën e tyre. D.m.th. ata marrin mbaresa sipas njëjës paraprijëse (e cila mund të jetë shquese dhe joshquese) dhe gjinisë, numrit (njëjës ose shumë) dhe rasës së emrit që ata cilësojnë.

Mbarea mbiemërore pas një shquese (der/ die / das/...)				
Njëjës				Shumës
	Mashk.	Asnj.	Fem.	
Emërore	-e	-e	-e	} (gjithmonë) -en
Kallëzore	-en	-e	-e	
Dhanore	-en	-en	-en	

Emërore	Kallëzore	Dhanore
der alte Bahnhof die alte Klinik das alte Haus	den alten Bahnhof die alte Klinik das alte Haus	auf dem alten Bahnhof in der alten Klinik in dem alten Haus
Shumës: Em.+ Kall. : Dhan. : mit	die alten den alten	Bahnhöfe, Kliniken, Häuser Bahnhöfen, Kliniken, Häusern

Mbarea mbiemërore pas një joshquese (ein/ eine/...)				
Njëjës				Shumës
	Mashk.	Asnj.	Fem.	
Em.	-er	-es	-e	} (gjithmonë) -en
Kall.	-en	-es	-e	
Dhan.	-en	-en	-en	

Emërore	Kallëzore	Dhanore
ein alter Bahnhof eine alte Klinik ein altes Haus	einen alten Bahnhof eine alte Klinik ein altes Haus	auf einem alten Bahnhof in einer alten Klinik in einem alten Haus
Shumës: Em.+ Kall. : Dhan. :	alte Bahnhöfe, Kliniken, Häuser mit alten Bahnhöfen, Kliniken, Häusern	

2. Krahasimi me *wie*

Kur mbiemrat përdoren në krahasime (pa një emër shoqëruar), ata nuk lakohen. Në këtë rast, mbiemrat marrin pas tyre fjalën **wie** (sa).

Gjuhë e folur: *Ex ist neugierig wie die Frau vom Schneider.*

Forma korrekte: *Ex ist **so** neugierig wie die Frau vom Schneider.*

3. Prapashtesat mbiemërore

Shumë mbiemra në gjermanisht formohen nga pjesë të tjera të ligjëratës (për shembull nga emrat ose nga foljet) duke shtuar një prapashtesë. Për shembull:

Emër + -lich: *der Freund + -lich* = *freundlich*
das Glück + -lich = *glücklich*

Emër + -ig: *die Neugier + -ig* = *neugierig*
die Trauer + -ig = *traurig*

Folje + -bar: *lernen + -bar* = *lernbar*
sehen + -bar = *sichtbar/unsichtbar*

– **isch:** *komisch, phantastisch, praktisch, französisch*

– **sam:** *seltam*

III Përemri i pacaktuar (nyja joshqese e përdorur si përemër)

Nyjet mund të përdoren edhe si përemra. D.m.th. ato mund të qëndrojnë më vete, në vend të një emri. Për shembull: *Möchtest du einen Wein? Ja, ich möchte einen.*

Në këtë rast, zakonisht, përemri i pacaktuar ka të njëjtën formë si nyja joshqese. Megjithatë, ekzistojnë tri përjashtime:

a) Nyja joshqese asnjëse **ein** (dhe emri që e ndjek) në rasat emërore dhe kallëzore bëhet **eins**.

Përemri merr **-s** të njëjës shqese **das**, për të treguar gjininë asnjëse.

das Geschenk:	Hier ist ein Geschenk für dich.
eins	Ich habe auch noch eins .

b) Nyja joshqese e gjinisë mashkullore **ein** (dhe emri që e ndjek) në rasën emërore bëhet **einer**.

Përemri merr **-r** të njëjës shqese **der**, për të treguar gjininë mashkullore.

der Teller:	Hier ist noch ein Teller.
einer	Hier ist auch noch einer .

c) Nyja shqese e shumësit **die** (dhe emri që e ndjek) zëvendësohen në rasën emërore dhe kallëzore nga **welche** (disa).

(die) Teller:	Hier sind noch welche . Es gibt noch welche .
---------------	---

Emërore		
Mashkullore	Asnjanëse	Femërore
Da steht ein Teller. Da steht einer . Da steht keiner .	Da steht ein Glas. Da steht eins . Da steht keins .	Da ist eine Serviette. Da ist eine . Da ist keine .
Shumës		
Da stehen welche .	Da stehen welche .	Da sind welche .
Kallëzore		
Mashkullore	Asnjanëse	Femërore
Ich habe einen Teller. Ich habe einen . Ich habe keinen .	Ich habe ein Glas. Ich habe eins . Ich habe keins .	Ich habe eine Serviette. Ich habe eine . Ich habe keine .
Shumës		
Ich habe welche .	Ich habe welche .	Ich habe welche .

IV Përemri pyetës *welch-*

Përemri pyetës *welch-* e ndryshon formën e tij. Ai merr mbaresa sipas emrit para të cilit ndodhet. Mbaresat janë të njëjta si të mbiemrave të paraprirë nga një nyjë joshqese:

	Mashkullore	Femërore	Asnjanëse
Em. Kall.	Welch er Dichter ...? Welch en Dichter ...?	Welch e Kirche ...? Welch e Kirche ...?	Welch es Auto ...? Welch es Auto ...?
Shumës: gjithmonë -e : Welch e Dichter, Kirchen, Autos ...?			

V Parafjalët

Shembujt e mëposhtëm janë nxjerrë nga tekstet e mësimëve të këtij libri. Ata jepen vetëm në kontekstin ku janë përdorur.

durch + kall.:	Das ist eine schöne Tour durch Berlin.
neben + dhan. (+ kall.):	neben den Niederlanden
über + kall. (+ dhan.):	Wir fahren über den Rhein.
von + dhan. ... nach + kall.:	von Westen nach Osten
von ... zu + dhan.:	eine Fahrt vom Zoo zum Alex
wegen + dhan.:	wegen Bello (wegen dem Hund)